

**PASQYRAT FINANCIARE DHE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR
PËR PERIUDHËN 01.01.2021-31.12.2021**

Klubi i Futbollit “Ballkani” Sh.p.k

**“UNIVERZUM- AUDIT” Sh.p.k.
Prishtinë**

Përmbajtja:

Informata të përgjithshme mbi entitetin.....	4
Raporti i auditorit të pamvarur.....	5
Pasqyrat financiare.....	7
Pasqyra e politikave të rëndësishme të kontabilitetit.....	10-12

SHKURTESAT E PËRDORURA:

SNA- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit

SNK- Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit

OJQ- Organizata Jo Qeveritare

ATK- Administrata Tatimore e Kosovës

TKPK- Trusti I Kursimeve Pensionale të Kosovës

1.INFORMATA TË PËRGJITHSHME

1. Informta të përgjithshme

Klubi i Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. me emër tregtar FC Ballkani, është regjistruar si Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Kompania është themeluar më 18.12.2017 dhe vepron në përputhje me dispozitat e ligjit "Për shoqëritë tregtare" nr. 02 / L-123, Ligji "Për Regjistrin Tregtar" nr. 02 / L-54, me numër unik identifikues 810079196. Adresa e operimit të kompanisë është në rruga Stadiumi i Qytetit në Suharekë, Republika e Kosovës.

Pronarët/Aksionarë

Cima Group Sh.A.me vlerë prej 50,000euro.....me 100% aksione

Arsim Kabashi

Pozita- Agjent i regjistruar

ID 103056215

Kodi	Përshkrimi	Tipi
9312	Aktivitetet e klubeve sportive	Primarë
9319	Aktivitetet e tjera sportive	Sekondarë
9609	Aktivitetet e tjera p.k.t.	Tjera
9313	Palestra e fitnesit	Tjera
7311	Agjencitë për publicitet	Tjera
7312	Publiciteti përmes mediave	Tjera
8551	Arsimi për sporte dhe rekreacion	Tjera
9311	Funksionimi i objekteve sportive	Tjera



RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

PER MENAXHMENTIN E Klubi i Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Opinionin

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Klubi i Futbollit "Ballkani" Sh.p.k., të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme. Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 2020, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistet Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistet Kontabël (Kodi i BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në IFAK, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin e BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizates.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme, të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin, me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinionimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit. Ne gjithashtu, ju japim personave të ngarkuar me qeverisjen një deklaratë që ne jemi në pajtim me kërkesat përkatëse etike në lidhje me pavarësinë, dhe ju komunikojmë atyre të gjitha lidhjet dhe çështjet e tjera që mundet në mënyrë të arësyeshme, të ndikojnë në pavarësinë tonë, dhe kur është e zbatueshme, masat mbrojtëse përkatëse.

"Univerzum Audit" Sh.p.k.

Besa Berisha-Auditore Ligjore

Tel.: +383 44 124 898

Adresa: Qendra Tregtare Bregu i Diellit Lok.26



Prishtinë, 21.03.2022

Pasqyra e pozicionit financiar(Bilancit) për periudhen 01.01.2021 - 31.12.2021

(Vlerat në Euro)

Pasuritë	Shënimi	31.12.2021	31.12.2020
Asetet aktuale			
Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e saj	12.3	117,277	47,424
Pasuritë tjera afatshkurta/Huat e dhena		228,000	150,000
Llogarite e arketueshme nga transferimi I lojtarëve		-	-
Llogarite e arketueshme nga grupet/ subjektet e nderlidhura		-	-
Llogarite e arketueshme (te tjera)		-	-
Parapagimet		-	-
Kerkesa per tatim te paguar me teper		-	-
Kerkesat e tjera		-	-
Totali I aseteve aktuale		345,277	197,424
Pasurite (Pasurite e qëndrueshme të trupëzuara)			
Pasurite e paprekshme - lojtarët		25,711	32,746
Pasurite e paprekshme – te tjera		-	-
Llogarite e arketueshme (te tjera)		-	-
Pasuritë e paprekshme-patrupzuara			
Invesimet afatgjate		-	-
Pasurite e tjera		-	-
Totali i pasurive themelore		25,710.90	32,746.27
Totali I aseteve		370,988	230,171
Detyrimet dhe ekuiteti			
<i>Detyrimet afatshkurtëra:</i>			
Detyrimet tjara afatshkurta/pagat		67,506	42,917
Tatimi ne paga I pagueshëm/kontributet		75,482	37,253
Obligimet per tatimet tjera		-	-
Tatimi mbi fitim i pagueshëm		-	-
Obligimet ndaj furnitorve		-	-
Detyrimet tjera afateshkurtëra		-	-
Totali I detyrimeve aktuale		142,988	80,171
Detyrime afatgjate			
Huatë afatëgjate		-	-
Detyrimet e tjera jokurente		-	-
Totali i detyrimeve afatgjate		-	-
Totali i Detyrimeve		142,988	80,171
Detyrimet tjera/Te hyrat e shtyera		228,000	150,000
Kapitali dhe rezervat:			
Kapitali aksionar		-	-
Fitimi I mbajtur		-	-
Gjithsejt ekuitetit		-	-
GJITHSEJ DETYRIME DHE EKUITET		370,988	230,171

Pasqyrat Financiare jane te aprovuara nga Bordi i Drejtoreve dhe jane autorizuar nga drejtori me 22.03.2022.

Drejtori



Drejtori Financiar/Kontabilist i Certifikuar

Pasqyra e te ardhurave për vitin qe perfundon me 31.12.2021

(Vlerat në Euro)

Të ardhurat	Shënimi	31.12.2021	31.12.2020
		-	-
Te hyrat nga donacionet	12.4	1,278,550	535,094
Te hyrat nga sponsorizimet dhe reklamat		111,500	239,435
Te hyrat nga shitjet e biletave		-	3,697
Të hyra tjera operative		-	5,127
Totali I te ardhurave		1,390,050	783,352
Shpenzimet operative			
Shpenzimet Materjale	12.5	(116,912)	(32,687)
Shpenzimet e perfitimit te punonjesve (lojtareve)	12.6	(960,439)	(597,301)
Shpenzimet e Zyrës & Administratës		(84,699)	(3,365)
Pagesat me para te gatshme per huazimet ndaj aksionarve/personave te nderlidhur		-	-
Totali I shpenzimeve operative		(1,162,050)	(633,352)
Fitimi/Humbja operative		228,000	150,000
Tregtimi(shitja) I lojtarve		-	-
Amortizimi i aktiveve jo-Materiale Fikse (regjistrimet e lojtarve)		-	-
Zhvlerësimi i aktiveve jo-Materiale (regjistrimet e lojtarve)		-	-
Fitimi / humbja nga shitja e lojtarve		-	-
Kostoja e regjistrimit te lojtarve (dukë përfshirë edhe agentet e pakapitalizuar / tarifat e ndërmjetme dhe kredite)		-	-
Te ardhurat ne dispozicion nga regjistrimet e lojtarve (dukë përfshirë të ardhurat e kredisë)		-	-
Totali nga shitja e lojtarve		-	-
Të ardhurat Financiare		-	-
Kostot financiare		-	-
Të dala të tjera financiare		-	-
Fitimet e këmbimit valutor neto / (Humbjet)		-	-
Te ardhurate neto financiare / shpenzimet		-	-
Fondet e bartuara		228,000.00	150,000.00
Fitimi ose humbja para taksave		-	-
Tatimi në fitim		-	-
Fitimi/Humbja neto për vitin		-	-

Pasqyra e rrjedhjes se parasë për vitin qe perfundon me 31.12.2021

(Vlerat në Euro)

Të hyrat nga Donacionet	12.4	1,390,050	779,655
Te hyrat nga shitjet e biletave		-	3,697
Te hyrat e shtyera		-	-
Humbja nga shitja e pasuris jo qarkulluese		-	-
Shpenzimet e interesit		-	-
Rritja/zvoglimi ne stoqe		-	-
Rritja/zvoglimi ne te arketueshmet		-	-
Rritja/zvoglimi ne te pagueshmet		-	-
Paraja e gatshme e gjeneruar nga operacionet		1,390,050	783,352
Daljet e Parasë:			
Shpenzimet e Pagave	12.6	(960,439)	(597,301)
Shpenzimet e Aktiviteteve & Operative	12.5	(201,611)	(36,051)
Obligimet rrjedhse		134,854	80,171
Rrjedhja neto e paras nga aktiviteti operativ		362,854	230,171
Tatime te paguara		(65,001)	(39,138)
Rrjedhja neto e paras aktivitetet investuese			
Arketimet e parase nga shitja e lojtarve te regjistruar		-	-
Pagesat e parase nga blerja e lojtarve te regjistruar		-	-
Pagesat me para te gatshme per huazimet ndaj aksionarve/personave te nderlidhur		(228,000)	(150,000)
Rrjedhja neto e paras nga aktivitetet investuese		(228,000)	(150,000)
Rrjedhja neto e paras nga aktivitetet financiare			
Emetimi i kapitalit akcionar		-	-
Te hyrat nga Donatoret		-	-
Te hyrat nga Shitjet		-	-
Rrjedhja e paras nga aktivitetet financiare		-	-
Rritja/zvoglimi i paras se gatshme për periudhen		69,853	41,033
Paraja e gatshme ne fillim te periudhes		47,424	6,392
Paraja e gatshme ne fund periudhes		117,277	47,424

1.DEKLARATA E PËRPUETHSHMËRISË

Pasqyrat financiare të Klubi i Futbollit "Ballkani" Sh.p.k janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

2.BAZA E PËRGATITJES DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Baza e matjes

Pasqyrat financiare për Klubin e Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. janë përgatitur në bazë të matjeve të përcaktuara me SNRF për secilin lloj të pasurisë, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e matjes janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në politikat e kontabilitetit të paraqitura më poshtë.

2.2 Valuta e përdorur

Valutë funksionale e Klubit te Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. është valuta Euro ("EUR"). Pasqyrat financiare janë prezantuar në euro.

2.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentët e parasë janë konsideruar të jenë paraja e gatshme si dhe ajo në llogari rrjedhëse. Klubi i Futbollit "Ballkani" Sh.p.k. operon me llogaritë bankare të hapura në BKT.

2.4 Asetet fikse të trupëzuara

Asetet fikse të trupëzuara paraqiten me koston minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të njohur nga zhvlersimi / amortizimi. Zhvlerësimi ngarkohet në mënyrë që të zvoglojë koston ose vlerësimin e aseteve përveq tokës dhe pronave në ndërtim e sipër, mbi jetën e tyre të vlerësuar të përdorimit duke përdorur metodën lineare, në bazë të mëposhtme:

Ndërtesat 5% në vit

Pajisjet dhe makineria e rendë 10% në vit

Pajisjet dhe makineria 20% në vit

Asetet e marra me qira zhvlerësohen për jetën e tyre të dobishme ekonomike të pritshme mbi bazën e njejtë si Asetet në pronësi ose, në periudhë më të shkurtër, gjatë afatit të qirasë përkatëse. Fitimi ose humbja që rrjedh ose nga shitja ose dalja jashtë përdorimit të një aktivi përcaktohet si diferencë midis të ardhurave të shitjes dhe vlerës kontabël të aktivitetit dhe njihet ne te ardhura.

2.5 Asetet Jo-materiale fikse – lojtarët

Transferimi dhe shpenzimet e rastit që lidhen me blerjen e lojtarëve të regjistruar kapitalizohen si aktive fikse të trupëzuara.

Këto kosto janë amortizuar plotësisht, në këste të barabarta vjetore, gjatë periudhës së kontratave të lojtarëve respektiv.

Nuk përfshihen shumat e lojtarëve brenda klubit. Kur rinegociohet një kontratë, së bashku me shpenzimet e reja që lidhen me zgjerimin e kësaj kontrate, duhet të amortizohen gjatë afatit të kontratës së re.

Çdo tarifë transferimi e pagueshme si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve në të ardhmen duhet të kapitalizohet, kur është e mundur që një ngjarje e tillë do të ndodhë.

Regjistrimet e lojtarëve duhet të zhvlerësohen, kur vlera kontabël neto tejkalon shumën e rikuperueshme përmes përdorimit ose shitjes.

2.6 Të hyrat

Të hyrat përfaqësojnë të ardhurat e arkëtueshme nga aktivitetet kryesore të njësisë ekonomike duke përfshirë tarifën e transferimit për shitjen e lojtarëve të regjistruar dhe tatimin mbi shitjen.

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtueshme për mallrat dhe shërbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit.

2.6.1 Faturat e hyrjes në stadion-të ardhurat nga ndeshjet e ditës

Të ardhurat e lojës së ditës njihen me ndeshjet e luajtura gjatë gjithë vitit dhe pranohen vetëm atëherë kur ka përfunduar ndeshja.

Të ardhurat e ndeshjes së ditës që janë marrë paraprakisht në fund të vitit, por kanë të bëjnë me vitin e ardhshëm (p.sh. Shitjet e biletave sezonale) duhet trajtuar si të ardhura të shtyra dhe regjistrohen si teardhura për ndeshje që kanë përfunduar.

2.6.2 Sponzorizimi dhe reklamimi

Sponzorizimi dhe reklamimi përfshijnë sponzorët kryesore, sponzorë të tjerë, perimetrin e ndeshjeve dhe reklamimet e bordit, si dhe sponzorizimin dhe reklamimet e tjera.

2.6.3 Të drejtat e transmetimit

Të ardhurat nga të drejtat e transmetimit përfaqësojnë të ardhurat e arkëtueshme nga kontratat e mediave vendore. Shpërndarjet në lidhje me performancën e ekipit njihen kur ato bëhen të sigurta.

2.6.4 Të hyrat komerciale

Të ardhurat komerciale përfshijnë të hyrat nga tregtimi, shitja e ushqimit dhe pijes, konferencat, dhe të ardhurat e tjera komerciale vetëm nëse nuk kategorizohen ndryshe.

2.6.5 Solidariteti i UEFA dhe çmimi i parasë

Çmimi i parasë së UEFA paraqet të hyrat e arkëtueshme nga pjesëmarrja në garat e UEFA-s.

Tregtimi dhe pagesat e participimit llogariten si shpenzime të ndeshjeve individuale.

Shpërndarja në lidhje me performancën e ekipit njihet vetëm atëherë kur llogaritet që është bërë për atë qëllim.

2.6.6 Të hyrat tjera

Të ardhurat tjera përfshijnë donacionet, grantet, mirpo asnjë të ardhur të jashtëzakonshme operative dhe të hyra të tjera jo të përfshira në pesë kategoritë e tjera.

3. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

	2021 €	2020 €
Paraja në arkë	105,747	47,380
Paraja në bankë	11,530	44
Depozitat afatshkurta bankare	-	-
Totali	117,277	47,424

4. Të hyrat nga Donacionet

	2021 Vlera e Kontratës €	2020 Realizimi i €
Te hyrat nga donacionet	1,390,050	774,528
Te hyrat nga shitjet e biletave	-	3,697
Te hyrat e shtyera & reklama	-	5,127
Totali	1,390,050	783,352

5. Shpenzimet e Aktiviteteve Operative

	2021 €	2020 €
Shp.e zyres	(16,299)	(3,365)
Gjyqtaret-Vezhguesit	(4,020)	(2,068)
Paisje Sportive	(16,592)	(3,279)
Materiale	(25,216)	(8,920)
Transfere te lojtarve	(2,135)	(3,085)
Reprezentacion	(68,950)	(15,334)
Total aktivitete & operative	(133,211)	(36,051)

6. Shpenzimet e Pagave

	2021 €	2020 €
Paga Bruto	926,686	572,477
Kontributi i punëdhënësit	33,753	24,824
Kontributi i punëtorit	33,753	24,824
Tatimi në paga	75,482	42,723
Paga neto	817,451	504,929
Paga Bruto & Kontributi i punëdhënësit	960,439	597,301